UDHËZIM
Nr. 32, datë 31.12.2013

PËR TATIMIN E THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL
(Ndryshuar me Udhëzimin nr. 13, datë 6.5.2014; nr. 25, datë 16.12.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar", ministri i Financave

UDHËZON:

1. Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim ka për qëllim që, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, të sigurojë qartësimin e kuptimit të dispozitave të tij për të garantuar zbatimin korrekt dhe në mënyrë uniforme për të gjithë tatimpaguesit dhe për të gjitha drejtoritë rajonale tatimore.

2. Tatimpaguesit, subjekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Për efekt të zbatimit të ligjit "Për sistemin e taksave vendore", me biznes do të kuptojmë çdo person fizik ose juridik, i cili ushtron veprimtari ekonomike për qëllime fitimi.

Periudha bazë që duhet të merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit është viti kalendarik, që do të thotë periudha nga 1 janari deri në 31 dhjetor. Në çdo rast, në qoftë se gjatë vitit kalendarik, qarkullimi tejkalon ose parashikohet të tejkalojë kufirin prej 8 milionë lekë, personi fizik ose juridik detyrohet të regjistrohet si tatimpagues i tatimit mbi fitimin.

Qarkullimi që merret parasysh është qarkullimi gjithsej i realizuar nga i njëjti person, pavarësisht nga statusi i tij. Në qoftë se një person ka disa veprimtari në të njëjtin vend ose në vende të ndryshme, qarkullimi që merret për bazë përfshin qarkullimin e të gjitha veprimtarive, në të gjitha vendndodhjet ku zhvillohet ajo.

3. Të ardhurat gjithsej dhe të ardhurat e tatueshme

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to, të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme. Të ardhurat e tatueshme apo fitimi i tatueshëm rezulton si diferencë e të ardhurave gjithsej të realizuar gjatë periudhës tatimore me shpenzimet e njohura.

4. Shkalla tatimore

4.1 Për tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 2 deri në 8 milionë lekë, aplikohet shkalla tatimore 7,5 % mbi fitimin e tatueshëm. Fitimi i tatueshëm nënkupton fitimin neto, pra diferencën e të ardhurave bruto me shpenzimet e zbritshme të biznesit, siç përcaktohet në ligj dhe në këtë udhëzim. Në çdo rast, për çdo tatimpagues dhe lloj veprimtarie, tatimi i llogaritur për këtë kategori, nuk mund të jetë më i vogël se 25.000 lekë në vit, ose jo më e vogël se pjesa proporcionale e vlerës prej 25.000 lekësh për periudhën e kryerjes së veprimtarisë, kur tatimpaguesit regjistrohen, çregjistrohen apo kalojnë në regjistrin pasiv, gjatë vitit.

5. Shpenzimet e njohura

a) Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm të thjeshtuar për biznesin e vogël, në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

b) Shpenzimet e njohura janë shpenzimet që njihen si të zbritshme për përcaktimin e fitimit të tatueshëm. Për të qenë të njohura (të zbritshme), shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte:

i) të jenë kryer në interes të drejtpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit;

ii) të jenë kryer ose të jenë përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetura në dokumente justifikuese të njohura ligjërisht;

iii) të jenë pasqyruar nëpërmjet një veprimi kontabël duke pakësuar aktivet neto;

iv) në çdo rast, shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor. Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e lëshuara nga persona jorezidentë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridikë (p.sh. ambasada të huaja, organizma ndërkombëtarë, zyra pune, komisariate policie, etj.) për pagesat e tarifave të shërbimeve që këto ente i kryejnë tatimpaguesve në Shqipëri.

6. Shpenzimet e panjohura

6.1. Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm për biznesin e vogël, nuk do të njihen si shpenzime të zbritshme, shpenzimet e mëposhtme:

a) kostoja e blerjes dhe e përmirësimit të tokës e të truallit;

b) kostoja e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të veprimtarisë, të cilat amortizohen, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar;

c) vlera e shpërblimeve në natyrë;

ç) interesat e paguar, të cilët tejkalojnë normën mesatare të interesit 12-mujor të kredisë, për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë;

d) gjobat, kamatëvonesat dhe kushtet e tjera penale;

dh) krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera speciale, përveç rasteve të parashikuara në ligj apo në akte nënligjore;

e) tatimi mbi të ardhurat personale dhe ato nga biznesi;

ë) shpenzimet për përfaqësim dhe për pritje-përcjellje, të cilat e tejkalojnë shumën 0,3 për qind të qarkullimit vjetor;

f) shpenzimet e konsumit personal, ku përfshihen të gjitha shpenzimet e karakterit të konsumit personal, të cilat nuk kanë lidhje direkte me mbarëvajtjen dhe rezultatin e biznesit. Të tilla shpenzime konsiderohen, për shembull, kur tatimpaguesi një pjesë të mallrave të prodhuara apo të tregtuara prej tij i përdor për konsum personal apo familjar, kur një pjesë të karburantit e përdor për automjetin personal apo familjar, shpenzimet telefonike për vete apo persona të tjerë që nuk janë të punësuar në biznes apo funksionet e tyre nuk i justifikojnë këto shpenzime. Gjithashtu, konsiderohen si shpenzime të konsumit personal dhe të panjohura për efekt fiskal edhe shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve vendas dhe të huaj, pavarësisht nga kushtet e vëna në kontratën e punësimit ose shërbimit.

g) shpenzimet, të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore. Për kufijtë e përcaktuar për qëllime tatimore në ligjin nr.7892, datë 21.11.1994 "Për sponsorizimet", nuk njihen si shpenzime të njohura shumat e sponsorizuara që tejkalojnë masën 3 për qind të fitimit para tatimit dhe shuma e sponsorizuar për botuesit e shtypit, e cila tejkalon masën 5 për qind të fitimit para tatimit;

gj) shpenzimet për dhurata;

h) çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi;

i) shpenzimet për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit, të faturuara nga persona të tretë, për të cilat nuk është paguar tatimi në burim, brenda periudhës tatimore nga tatimpaguesi;

j) humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, transitimit dhe magazinimit tej normave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore;

k) shpenzimet për pagat, shpërblime dhe çdo formë tjetër të të ardhurave personale, të cilat lidhen me të ardhurat nga marrëdhëniet me punësimin, që u janë paguar të punësuarve, përfshirë dhe administratorët, pa kaluar nëpërmjet sistemit bankar. Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

l) shumat e paguara në *cash*, mbi kufijtë e përcaktuar në ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë". Rastet e përjashtimit nga ky rregull janë të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

ll) nëse gjatë periudhës tatimore huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkaluar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm;

m) borxhi i keq, nëse nuk plotësohen tri kushtet e përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar. Një borxh i keq, që është mbledhur, duhet të përfshihet si e ardhur në çastin e mbledhjes;

n) shpenzimet e kryera për dieta të cilat kalojnë kufirin prej 3 mijë lekë për ditë të plota shërbimi brenda vendit dhe 1 mijë lekë për gjysmë ditë shërbimi brenda vendit, si dhe shpenzimet e kryera për dieta jashtë vendit të cilat kalojnë kufirin prej 60 euro për çdo ditë të plotë shërbimi dhe 30 euro për çdo gjysmë dite shërbimi. Shpenzimet për shërbimet e biznesit brenda ose jashtë vendit duhet të justifikohen me dokumentet përkatëse të udhëtimit, si dokumentet e transportit, faturat e hotelit, pasaporta (vulat e hyrjes e të daljes nga vendi), etj., si dhe dokumentacioni teknik që vërteton nevojat e biznesit të shërbimit brenda ose jashtë vendit; etj.

nj) shpenzimet për asetet kapitale, përveç shpenzimeve për tokën, veprat e artit dhe pasuri të tjera që nuk amortizohen, në pronësi të tatimpaguesit dhe të përdorura për veprimtaritë e biznesit të tatimpaguesit, do të mbulohen gjatë kohës përmes shpenzimeve të amortizimit, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

i) Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e të pajisjeve, me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, në mënyrë lineare, me 5 për qind;

ii) Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind;

iii) Kompjuterët, sistemet e informacionit, produktet software dhe pajisjet e ruajtjes të të dhënave amortizohen në bazë të vlerës së grupit, me 25 për qind;

iv) Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë, me 20 për qind.

6.2. Baza e amortizimit është vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore, duke i shtuar koston e blerjes apo të krijimit të aktivit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë, gjatë periudhës tatimore dhe duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve, për shkak të forcave të tjera madhore ose të shndërrimeve të tjera të pavullnetshme, gjatë periudhës tatimore. Në rastin kur baza e amortizimit është një shumë negative, kjo shumë i shtohet së ardhurës së tatueshme dhe baza e amortizimit merret zero. Në rastin kur baza e amortizimit nuk kalon 5,000 lekë, e gjithë baza e amortizimit është një shpenzim i zbritshëm i veprimtarisë. Në rastin kur bëhet rivlerësim i aktiveve të veprimtarisë, nuk lejohet të llogaritet amortizimi për shumën e rivlerësuar.

6.3. Normat e amortizimit sipas grupeve janë në përputhje me udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

7. Mbajtja e regjistrimeve

7.1. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit për çdo shitje të kryer, janë të detyruar:

a) të lëshojnë për çdo shitje mallrash apo shërbimesh, faturë të thjeshtë tatimore për çdo blerës të tatueshëm që merr furnizimin. Forma dhe përmbajtja e faturës së thjeshtë tatimore është përcaktuar në shtojcën nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Këta tatimpagues janë të detyruar të lëshojnë faturë të thjeshtë tatimore edhe për çdo shitje mallrash e shërbimesh të kryer për organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve, entet publike kombëtare e vendore, organizatat politike dhe organet e tjera të ngjashme me to, që kryejnë veprimtari të ndryshme.

b) Tatimpaguesi që realizon një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit si shitës me pakicë, për çdo shitje në njësitë e shitjes me pakicë, të kryer për individë konsumatorë finalë, është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me pajisje fiskale dhe në mungesë të saj, dëftesë tatimore. Kuponi tatimor lëshohet nga të gjithë tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të cilët, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, janë të detyruar të pajisen me pajisje fiskale. Dëftesa tatimore lëshohet nga të gjithë tatimpaguesit shitës me pakicë, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të cilët për arsye objektive, si: prishje e pajisjes fiskale apo mungesa e energjisë elektrike ose që, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007, nuk janë të detyruar të pajisen me pajisje fiskale. Rolin e dëftesës tatimore/kuponit tatimor mund ta luajnë edhe dokumente të tjera të miratuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore, si për shembull biletat e transportit të udhëtarëve.

c) Kuponi tatimor i lëshuar me arkë regjistruese (pajisje fiskale), si dhe dëftesa tatimore nuk mund të shërbejnë si dokumente justifikuese të shpenzimeve të zbritshme të biznesit për blerësin, përveç rastit kur shoqërohen edhe me faturë të thjeshtë tatimore.

d) Tatimpaguesi, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, për çdo lëvizje të brendshme të mallrave nga magazina në magazinë, nga magazina në dyqan, apo anasjelltas, nga vendi i

prodhimit në magazinë apo nga vendi i prodhimit në dyqan, sipas përcaktimeve në ligjin për procedurat tatimore, është i detyruar të lëshojë faturën e shoqërimit të mallit.

7.2. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, çdo blerje të tyre janë të detyruar ta justifikojnë me:

a) faturë tatimore me TVSH, kur blerja është kryer te personat e regjistruar si tatimpagues të TVSH-së.

b) faturë të thjeshtë tatimore, kur blerja është kryer te personat e regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe nuk janë tatimpagues të TVSH-së.

7.3. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, për shkeljet e kryera lidhur me dokumentacionin justifikues në shitje dhe në blerje, penalizohen sipas përcaktimeve të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij.

7.4. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, janë të detyruar të mbajnë:

a) librin e shitjeve, ku regjistrojnë në mënyrë kronologjike çdo shitje të kryer me faturë të thjeshtë tatimore, si dhe totalin e shitjeve ditore të kryer me kupona tatimorë;

b) librin e blerjeve, ku regjistrojnë në mënyrë kronologjike çdo blerje të kryer me faturë tatimore, me TVSH, me faturë të thjeshtë tatimore;

c) libri i shpenzimeve dhe të ardhurave;

d) librin e aktiveve të biznesit.

7.5 Forma dhe përmbajtja e librit të shitjeve, librit të blerjeve, librit të shpenzimeve dhe të ardhurave, librit të aktiveve të biznesit, janë sipas formularëve përkatës, shtojcat nr. 2, shtojca nr.3, shtojca nr.4, shtojca nr.5, shtojca nr.6 dhe shtojca nr.7, bashkëngjitur këtij udhëzimi,

7.6 Për tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që janë të regjistruar në TVSH, libri i shitjeve dhe libri i blerjeve të mbajtura për efekte të TVSH-së, shërbejnë si të tillë edhe për efekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

7.7 Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël me qarkullim vjetor deri në 2,000,000 lekë për çdo shitje të kryer janë të detyruar të lëshojnë faturë të thjeshtë tatimore, kupon tatimor ose dëftesë tatimore. Ata janë të detyruar gjithashtu që çdo blerje të kryer ta justifikojnë me faturë tatimore me TVSH ose faturë të thjeshtë tatimore.

8. *Parapagimi i detyrimit tatimor.*

8.1 Parapagimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin nga tatimpaguesit me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë.

Gjatë vitit ushtrimor, tatimpaguesit që janë subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël me qarkullim vjetor në intervalin nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, e paguajnë detyrimin tatimor në formë parapagimesh, të ndara në katër këste tremujore gjatë vitit.

Llogaritja e detyrimit tatimor dhe e kësteve tremujore për vitin vijues, bazohet në të dhënat e "Formularit të deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin" të vitit paraardhës, që është bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërë e tij. Pra, katër kështet e detyrimit tatimor të vitit vijues, llogariten duke marrë në konsideratë fitimin e deklaruar dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e llogaritur nga tatimpaguesi për vitin paraardhës. Kështet e parapagimeve, të përcaktuara mbi këtë bazë, u njoftohen tatimpaguesve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, brenda datës 1 prill të çdo viti.

Kështet e parapagimeve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të llogaritura si më sipër, për vitin ushtrimor, paguhen nga tatimpaguesit në afatet e mëposhtme:

- brenda datës 20 prill për tremujorin e parë;

- brenda datës 20 korrik për tremujorin e dytë;

- brenda datës 20 tetor për tremujorin e tretë;

- brenda datës 20 dhjetor për tremujorin e katërt.

Pagesa e kësteve të parapagimeve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin bëhet në bankat e nivelit të dytë ose Postës Shqiptare, nëpërmjet urdhërpagesës përkatëse të gjeneruar nga sistemi informatik i tatimeve.

Shembull:

Tatimpaguesi X, i regjistruar si biznes i vogël me veprimtari në fushën e tregtisë me pakicë të artikujve ushqimorë, ka dorëzuar deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2014. Shuma e fitimit neto të deklaruar është 800.000 lekë. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin i llogaritur dhe i deklaruar për vitin 2014

është: 800.000 lekë x 7,5 % = 60.000 lekë.

Për vitin 2015, shuma e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin që tatimpaguesi duhet të paguajë në formë parapagimesh do të jetë 60.000 lekë, e ndarë në katër këste si më poshtë:

- brenda datës 20 prill, 15.000 lekë;

- brenda datës 20 korrik, 15.000 lekë;

- brenda datës 20 tetor, 15.000 lekë; dhe

- brenda datës 20 dhjetor, 15.000 lekë.

8.2 Pagimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin nga tatimpaguesit me qarkullim nga zero deri në 2 milionë lekë.

Gjatë vitit ushtrimor, tatimpaguesit subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të cilët realizojnë qarkullim vjetor në intervalin nga zero deri në 2 milionë lekë, paguajnë detyrim tatimor, shumën fikse në masën 25 000 lekë në vit. Ky detyrim u njoftohet tatimpaguesve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, brenda datës 1 prill të çdo viti.

Pagesa e detyrimit tatimor në shumën 25 000 lekë për këtë kategori tatimpaguesish, kryhet brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti.

Nëse tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të cilët realizojnë qarkullim vjetor në intervalin nga zero deri në 2 milionë lekë, regjistrohen si tatimpagues dhe fillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike gjatë gjysmës së dytë të vitit, pra në periudhën korrik - dhjetor, ato e paguajnë detyrimin e tyre tatimor fiks të përcaktuar në bazë të proporcionalitetit, brenda datës 20 dhjetor të atij viti. Kështu, tatimpaguesi i regjistruar në muajin tetor të vitit vijues, i cili parashikon se do të realizojë një qarkullim vjetor nga zero deri në 2 milionë lekë, paguan tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në proporcion me muajt e vitit që ka kryer aktivitet tregtar. Në këtë rast, tatimi për t'u paguar nga tatimpaguesi do të jetë 25.000 lekë shumëzuar me raportin 3/12 (6 250 lekë).

8.3 Periudha për të cilën llogaritet detyrimi tatimor

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin deklarohet dhe paguhet për periudhën gjatë së cilës tatimpaguesi ka ushtruar veprimtari ekonomike. Në rastet kur veprimtaria e biznesit hapet, mbyllet apo pezullohet gjatë vitit fiskal, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, llogaritet në mënyrë proporcionale me kohën e ushtrimit të veprimtarisë, mbështetur në vetëdeklarimin e tatimpaguesit.

Në rastin kur tatimpaguesi, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, regjistrohet për herë të parë gjatë vitit, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin llogaritet në bazë të qarkullimit dhe të fitimit të tatueshëm, të parashikuar nga vetë tatimpaguesi, për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik.

Shembull

Nëse tatimpaguesi X regjistrohet në QKR dhe në administratën tatimore në datën 1 korrik 2014, dhe deklaron se për periudhën e mbetur të vitit do të realizojë një fitim prej 1.200.000 lekësh, ai do të llogarisë 1.200.000 x 7,5 % = 90.000 lekë tatim të thjeshtuar mbi fitimin, të ndarë në dy këste për tremujorin e tretë dhe për tremujorin e katërt, të cilët do të paguhen:

- brenda datës 20 tetor, 45.000 lekë dhe,

- brenda datës 20 dhjetor, 45.000 lekë.

Kur tatimpaguesi e fillon aktivitetin e tij gjatë një muaji, ky muaj llogaritet si muaj i plotë për efekt të përcaktimit të detyrimit tatimor. Kështu, nëse tatimpaguesi regjistrohet për herë të parë në 20 korrik të vitit vijues, tatimi i thjeshtuar i fitimit për t'u parapaguar brenda vitit do të përpjesëtohet me 6/12. Në të njëjtën mënyrë si më sipër në këtë pikë, veprohet edhe në rastet kur tatimpaguesi çregjistrohet apo kalon në regjistrin pasiv të tatimpaguesve.

8.4 Llogaritja e kësteve të detyrimit tatimor në mungesë të deklaratës së tatimpaguesit.

Për tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të cilët nuk kanë dorëzuar deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin të vitit paraardhës deri në datën 10 shkurt të vitit pasardhës, Drejtoria Rajonale Tatimore llogarit vetë shumën e detyrimit tatimor të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e tatimpaguesit dhe mbi këtë bazë përcakton kështet tremujore që duhet të paguhen nga ai. Drejtoria Rajonale Tatimore njofton tatimpaguesin për kështet e tatimit që ai duhet të paguajë për çdo tremujor. Llogaritja e detyrimit tatimor në mungesë të deklaratës vjetore, bëhet duke u bazuar në metodat alternative të parashikuara në nenet 71 dhe 72 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në pikat 71 dhe 72 të udhëzimit për zbatimin e këtij ligji. Përdorimi i metodave alternative merr në konsideratë dokumentacionin dhe informacionin që disponohet për tatimpaguesin, faktet dhe rrethanat

e biznesit të tij, situatën e tatimpaguesve të tjerë të ngjashëm etj. Qëllimi është që nëpërmjet përdorimit të metodave të lejuara nga ligji, të llogariten sa më saktë detyrimet tatimore të tatimpaguesit mosdeklarues, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

8.5 Ndryshimi gjatë vitit i kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Llogaritja e detyrimit tatimor vjetor dhe e kësteve tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin vijues, bazohet në fitimin e realizuar nga tatimpaguesi në vitin paraardhës, të deklaruar nga ai nëpërmjet "Formularit të deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin".

Në rastet kur tatimpaguesi, mbas dorëzimit të "Formularit të deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin" kërkon, argumenton, provon dhe vërteton se fitimi i tij për këtë periudhë tatimore vijuese do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se fitimi i periudhës paraardhëse, mbi bazën e të cilit është përcaktuar detyrimi tatimor vjetor dhe këstet tremujore, Drejtoria Rajonale Tatimore zvogëlon shumën e parapagimeve për tremujorët e mbetur, pas paraqitjes së kërkesës.

Si prova të cilat justifikojnë uljen domethënës të fitimit, mund të jenë:

i) rënia e ndjeshme e qarkullimit e vërtetuar me raportet e kasave regjistruese;

ii) rënia e klientelës;

iii) hapja e veprimtarive të ngjashme në të njëjtën zonë;

iv) reduktime në oraret e biznesit;

v) largime të përkohshme nga biznesi për arsye të ndryshme.

Në këtë rast, Drejtoria Rajonale Tatimore duhet të njoftojë tatimpaguesin për pranimin ose jo të uljes të kësteve të parapagimit, brenda një muaji nga kërkesa e tatimpaguesit. Brenda kësaj periudhe, Drejtoria Rajonale Tatimore ka të drejtë të bëjë verifikime dhe kontrolle në lidhje me vërtetësinë e kërkesës.

Nëse Drejtoria Rajonale Tatimore vlerëson dhe ka të dhëna se fitimi i tatimpaguesit për periudhën vijuese tatimore do të tejkalojë me më tepër se 10 për qind tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e periudhës së mëparshme tatimore, mund të rregullojë në rritje parapagimet. Rritja bëhet për këstet e periudhës nga moment i konstatimit deri në fund të vitit. Tatimpaguesi njoftohet për rritjen e kësteve të parapagimit, si dhe për faktet dhe argumentet që kanë çuar në këtë rritje. Rritja e kësteve bëhet si pasojë e kontrolleve apo verifikimeve që mund të bëhen në vendin e biznesit të tatimpaguesit apo të dhënave të tjera që mund të disponon Drejtoria Rajonale Tatimore nga burime të ndryshme informacioni.

8.6 Procedura e pagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin

Pagesa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël kryhet në bankat e nivelit të dytë për llogari të organeve tatimore. Për të paguar shumën e detyrimit tatimor ose këstet e parapagimeve të përcaktuara, tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël përdorin urdhërpagesën e cila gjenerohet nga sistemi informatik i tatimeve dhe printohet nga vetë tatimpaguesi. Tatimpaguesi dorëzon në bankë apo në Postën Shqiptare dy kopje të urdhërpagesës, të cilat pasi verifikohen dhe pasi bëhet pagesa, firmosen dhe vulosen nga banka/posta shqiptare. Një kopje e urdhërpagesës mbahet nga banka/posta dhe kopja tjetër i jepet tatimpaguesit.

Tatimpaguesi, kopjen e urdhërpagesës të firmosur dhe vulosur nga banka/posta, së bashku me mandatarkëtimin e bankës/postës për shumën e detyrimit të paguar (i cili vërteton pagesën e kryer) dhe një kërkesë formale për pajisje me "Pullë tatimi", ia paraqet Zyrës së Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku ai është regjistruar. Zyra e Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku tatimpaguesi është i regjistruar, mbas verifikimit dhe konfirmimit të pagesës së bërë, e pajis tatimpaguesin me "Pullën e tatimit" të këstit të detyrimit tatimor për të cilin ka bërë pagesën. Dokumentet e mësipërme, përfshirë kërkesën për pajisje me "Pullë tatimi", urdhërpagesa dhe mandatarkëtimi, të dorëzuar nga tatimpaguesi, protokollohen dhe depozitohen në dosjen e tatimpaguesit.

Dizenjot dhe elementet e "pullës se tatimit" përcaktohen me udhëzim të veçantë të ministrit të Financave. Tatimpaguesi e vendos pullën e tatimit në pjesën e sipërme të Certifikatës së Regjistrimit në QKR, për të lehtësuar verifikimin e pagesave dhe ushtrimin e kontrollit vizual nga organet kompetente tatimore. Pulla e tatimit prodhohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë. Shpenzimet për prodhimin e saj përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Pulla e tatimit përmban elemente të sigurisë së lartë për të shmangur falsifikimin e tyre.

Tatimpaguesit me qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, të cilët paguajnë katër këste të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në një vit fiskal, pajisen me "pullë tatimi" për çdo pagesë të bërë, pra me katër "pulla tatimi" tatimi për një vit. Tatimpaguesit me qarkullim nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit, të cilët paguajnë tatimin fiks, në masën 25.000 lekë në vit vetëm me një këst, pajisen vetëm me një "pullë tatimi" të cilën e

vendosin në pjesën e sipërme të Certifikatës së Regjistrimit në QKR.

8.7 Evidentimi i pagesave dhe informimi i njësive të qeverisjes vendore

Drejtoritë rajonale tatimore pas rakordimit me bankat, bëjnë regjistrimin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Regjistri i arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së tatimit me njësitë e qeverisjes vendore. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë në format letër ose në version elektronik, forma dhe përmbajtja e të cilit përcaktohen me këtë udhëzim. Në bazë të të dhënave të regjistrit, përgatitet informacioni për çdo njësi të qeverisjes vendore i cili u kalon këtyre njësive po në formë elektronike brenda muajit vijues pasardhës të çdo tremujori për të cilin është kryer pagesa.

9. Deklarimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

9.1 Të gjithë tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, përfshirë:

- tatimpaguesit që realizojnë qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit dhe paguajnë katër këste parapagimesh të detyrimit tatimor në vit;

- tatimpaguesit që realizojnë qarkullim nga zero deri në 2 milionë lekë në vit dhe paguajnë një shumë fikse detyrimi tatimor në vit;

janë të detyruar që, brenda datës 10 shkurt të vitit pasardhës, të dorëzojnë formularin e "Deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin" për vitin raportues. Deklarata e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin përmban informacion në lidhje me të ardhurat gjithsej, shpenzimet gjithsej, shpenzimet e zbritshme, të ardhurat neto të tatueshme, tatimin për t'u paguar, si dhe informacione të tjera të kërkuara në deklaratë.

9.2 Deklarata e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dorëzohet nga tatimpaguesi në rrugë elektronike dhe ajo ka formën dhe përmbajtjen sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Deklarata plotësohet në përputhje me shënimet sqaruese të dhëna mbrapa saj. Formulari i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin së bashku më shënimet sqaruese lidhur me plotësimin e tij është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

9.3 Për tatimpaguesit, që realizojnë qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, tatimi i llogaritur në bazë të "Deklaratës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin", pakësuar me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, pas dorëzimit të deklaratës vjetore.

10. Administrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me administrimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sipas procedurave të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.*Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohet agjent shërbimi i këtyre të fundit. Si e tillë, DRT-ja regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 "Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim" me kartela analitike për çdo bashki dhe komunë.*

Drejtoritë rajonale tatimore janë të ngarkuara me transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Ato krijojnë një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël në bazë të të dhënave që marrin nga bashkitë dhe komunat.

11. Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore

a) Administrata tatimore qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur është arkëtuar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.

b) Administrata tatimore qendrore për shërbimin që kryen, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të administratës tatimore qendrore. Komisioni kalon në llogari të buxhetit të shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore, për mbulimin e kostove të "Pullave të tatimit".

c) Drejtoria rajonale tatimore pajis degën e tatimeve të bashkisë ose komunës me një listë të tatimpaguesve të regjistruar, si dhe vendndodhjet e biznesit brenda juridiksionit të tyre. Kjo listë identifikon qartë emrin dhe NIPT-in e tatimpaguesit, adresën e vendndodhjes së biznesit dhe shumën e tatimit të paguar.

Për të bërë transferimin, paraprakisht, kryhet procesi i rakordimit midis drejtorive rajonale tatimore me bashkitë dhe komunat, lidhur me shumat e arkëtuara sipas subjekteve tatimpaguese. Në aktrakordimin e hartuar në tri kopje, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi, paraqitet e ndarë shuma totale e arkëtuar për bashkinë/komunën, si dhe shuma e komisionit në masën 1% e të ardhurave të arkëtuara.

Drejtoritë rajonale tatimore, në bazë të aktrakordimit dhe listës së tatimpaguesve të konfirmuar nga të

dyja palët, kryen transfertën nga llogaria e drejtorive rajonale "Tatime me deklarim", në llogarinë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në rrethin përkatës, në emër të bashkisë apo komunës.

Drejtoritë rajonale tatimore dërgojnë pranë degës së thesarit të rrethit përkatës një kopje të aktrakordimeve të mbajtura me secilën bashki/komunë.Në bazë të aktrakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 "Transferta në institucionet nacionale" në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatik nga bashkia/komuna në drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 "Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale.

d) Punonjësit e zyrës së tatimeve të bashkisë ose komunës duhet të përdorin këtë informacion për të informuar drejtorinë rajonale tatimore për çdo biznes të njohur i cili nuk është pajisur me certifikatë regjistrimi.

12. Bashkëpunimi

a) Bashkia dhe komuna, kur e gjykojnë të nevojshme, i kërkojnë drejtorisë rajonale tatimore përkatëse kryerjen e veprimeve për plotësimin e detyrave për administrimin e tatimit dhe derdhjen në favor të saj, sipas afatit ligjor të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar i fitimit mbi biznesin e vogël.

b) Brenda datës 30 janar 2014, njësitë e qeverisjes vendore u përcjellin drejtorive rajonale tatimore të gjitha të dhënat për subjektet me qarkullim vjetor nga 0 në 8 milionë lekë, përfshirë këtu qarkullimin gjithsej dhe taksën vendore mbi biznesin e vogël të paguar. Këto të dhëna grupohen nga ana e njësive të qeverisjes vendore sipas qarkullimit tatimpaguesit me qarkullim nga zero deri në 2 milionë lekë dhe tatimpaguesit me qarkullim nga 2,000,000 lekë deri në 8 milionë lekë.

c) Pas marrjes së këtyre të dhënave, drejtoritë rajonale tatimore njoftojnë tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga zero lekë deri në 2 milionë lekë për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në masën 25,000 lekë dhe tatimpaguesit me qarkullim vjetor 2 deri në 8 milionë lekë për llogaritjen e kësteve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin brenda datës 1 prill të vitit 2014.

Ku udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2014.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Shtojca nr 1 :
(Ndryshuar me udhëzimin nr. 25, datë 16.12.2014)

FORMULAR I DEKLARIMIT TË TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD) (vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

	(1) Numri serial:_____

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT):
(3) _____
Emri tregtar i personit të tatueshëm: **(4)** _____
Emri /mbiemri i personit fizik: **(5)** _____
Adresa: **(6)** _____
Qyteti/komuna/rrethi:
Numri i telefonit: **(7)** _____
Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Të ardhurat dhe shpenzimet	**Të ushtrimit**	**Tatimore**
[8/9] Të ardhurat	**[8]**	**[9]**
[10/11] Shpenzimet	**[10]**	**[11]**
[12] Shpenzimet e panjohura		**[12]**

Rezultati

[13/14] Humbja	**[13]**	**[14]**
[15/16] Fitimi	**[15]**	**[16]**
[17] Fitimi i tatueshëm		**[17]**

Llogaritja e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin

[18] Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin me shkallën tatimore standarde	**[18]**
[19] Tatim fiks	**[19]**
[20] TOTALI PËR T'U PAGUAR	**[20]**

_____
Data dhe firma e personit të tatueshëm - Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

Udhëzues për mënyrën e plotësimit të formularit të deklarimit dhe pagesës

1. **Numri serial** gjenerohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhurnuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.
2. **Periudha tatimore** është vjetore.
3. **Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT)** është numri i dhënë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit /Drejtoria Rajonale Tatimore dhe që identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale Tatimore.
4. **Emri tregtar i personit të tatueshëm** është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në certifikatën e NIPT-it.
5. **Emri/mbiemri i personit fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar.
6. **Adresa** tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është treguar edhe në certifikatën e NIPT –it.
7. **Numri i telefonit** (n.q.s. ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.
8. **Të ardhurat e ushtrimit** janë të ardhurat totale të periudhës ushtrimore.
9. **Të ardhurat tatimore** janë të ardhurat që i përkasin aktivitetit të tatueshëm.
10. **Shpenzimet e ushtrimit** janë shpenzimet totale të periudhës ushtrimore.
11. **Shpenzimet tatimore** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm.

12. **Shpenzimet e panjohura** janë shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm dhe që nuk njihen si të zbritshme për efekt të llogaritjes së fitimit të thjeshtuar të tatueshëm.
13. **Humbja e ushtrimit** është diferenca e shpenzimeve të ushtrimit (kutia 10) me të ardhurat e ushtrimit (kutia 8) në rast se shpenzimet e ushtrimit janë më të mëdha se të ardhurat e ushtrimit.
14. **Humbja tatimore** është diferenca e shpenzimeve tatimore (kutia 11) pasi të zbriten shpenzimet e panjohura (kutia12), me të ardhurat tatimore (kutia 9) në rast se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e panjohura janë më të mëdha se të ardhurat e tatimore (9-11+12).
15. **Fitimi i ushtrimit** është diferenca e të ardhurave të ushtrimit (kutia 8) me shpenzimet e ushtrimit (kutia 10) në rast se të ardhurat e ushtrimit janë më të mëdha se shpenzimet e ushtrimit,
16. **Fitimi tatimor** është diferenca e të ardhurave tatimore (kutia 9), me shpenzimet tatimore (kutia 11) pasi janë zbritur nga këto të fundit shpenzimet e pazbritshme në rast se të ardhurat tatimore janë më të mëdha se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme (9-11+12).
17. **Fitimi i tatueshëm** është fitimi që tatohet me shkallën tatimore të përcaktuar në ligjin për taksat vendore.
18. **Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin me shkallë tatimore standarde** është shuma e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e llogaritur me shkallën tatimore standarde sipas vitit ushtrimor përkatës,e përcaktuar në bazë të ligjit për sistemin e taksave vendore. (Rub.[17] x shkallen tatimore%), por jo më e vogël se 25.000 lekë ose jo më e vogël se pjesa e proporcionale e vlerës prej 25.000 lekë për periudhën që ushtron aktivitet, si rezultat i regjistrimit ose çregjistrimit të tij brenda vitit të deklarimit.
19. **Tatim fiks** është shuma e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin që duhet të paguajnë të gjithë tatimpaguesit me qarkullim nga zero deri në 2 milionë lekë në vit, ose shuma proporcionale e tatimit fiks për periudhën që ushtron aktivitet, si rezultat i regjistrimit ose çregjistrimit të tij brenda vitit të deklarimit.
20. **Totali për t'u paguar** është shuma e tatim të thjeshtuar mbi fitimin të detyrueshëm për t'u paguar .

Shtojca nr. 2: LIBRI I SHITJEVE (qarkullimit)

TATIMPAGUESI _____

NIPT(NUIS) _____

AKTIVITET_____

Nr. _____

LIBRI I SHITJEVE (qarkullimit)

Viti_____Muaji_____

Numri Rendor	Data e muajit	SHITJET			Totali ditor
		Me faturë të thjeshtë tatimore	Me kupon kase	Me dëftesë tatimore	(3+4+5)
1	2	3	4	5	6

TOTALI MUJOR					

Shënim: Libri i shitjeve do të plotësohet nga tatimpaguesi në fund të çdo ditë pune, duke regjistruar të dhënat ditore.
- Në rubrikën "tatimpaguesi" do të shënohet emri që pasqyrohet në certifikatën e NIPT-it (NUIS).
- Në kolonën 3 regjistrohen të gjitha shitjet ditore të kryera me faturë të thjeshtë tatimore.
- Në kolonën 4 regjistrohen të gjitha shitjet ditore të kryera me kupon tatimor.
- Në kolonën 5 regjistrohen të gjitha shitjet ditore të kryera me dëftesë tatimore.
- Në kolonën 6 regjistrohet totali i të gjitha shitjeve ditore të kryera (3+4+5). Ky libër nuk plotësohet nga tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në.

EMËR MBIEMËR

_____

Shtojca nr. 3: LIBRI I BLERJES

TATIMPAGUESI_____

NIPT _____

AKTIVITET_____

Nr. _____

LIBRI I BLERJES

Viti____ Muaji_____

Data	**Blerje brenda vendit**		**Blerje nga importi**		**Totali i blerjeve ditore**
	Me faturë me TVSH	**Me faturë të thjeshtë tatimore**	**Nga importi**	**Shërbime**	
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**

TOTALI MUJOR					

Shënim. - Libri do të plotësohet nga tatimpaguesi në fund të çdo dite pune, duke regjistruar të dhënat ditore.

- Në kolonën 2 regjistrohen të gjitha blerjet nga tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në.
- Në kolonën 3 regjistrohen të gjitha blerjet nga tatimpaguesit e regjistruar për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.
- Në kolonën 4 regjistrohen të gjitha blerjet nga importi.
- Në kolonën 5 regjistrohen të gjitha blerjet për shërbimet e marra nga jashtë vendit.
- Në kolonën 6 regjistrohet totali i të gjitha blerjeve ditore të kryera (2+3+4+5).

Ky libër nuk plotësohet nga tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në.

EMËR MBIEMËR

_____

Shtojca nr. 4 : LIBRI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

LIBRI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Të ardhurat e shpenzimet për vitin.....

Tatimpaguesi.....

NIPT.....

Aktivitet.....

Nr.	**SHPENZIMET**	***vleft Në***	**Nr.**	**TË ARDHURAT**	***Vlefta Në***
9	**Kostoja e lëndëve të para dhe materialeve të**		1	Nga shitia e produkteve të	
a	Blerje lëndë të para e materiale gjatë vitit		2	Nga shitia e shërbimeve	
b	Giendje nga inventari		3	Nga shitia e mallrave	
2	**Kostoja e mallrave të shitura (a-b)**		4	Nga shitia e materialeve	
a	Blerje mallra gjatë vitit		5	Nga shitia e aktiveve	
b	Giendje nga inventari		6	Arkëtimi i debitorëve të	
3	**Shpenzime në funksion të aktivitetit**		7	Interesa të fituar dhe të	
a	Energjia, uji, telefoni, faksi, interneti		8	Diferenca pozitive nga	
b	Shpenzime të qarkullimit të mallit e transportit			**TOTALI I TË**	
c	Benzinë/naftë/gaz				
d	Qira ambienti				
e	Pagesa të kreditoreve për shlyerje dhe huave				
f	Interesa të paguar dhe komisione bankare			REZULTATI (TË	
g	Diferenca negative nga këmbimi valutor				
h	Taksa doganore		**A**	**FITIM**	
i	Shpenzime administrative, mirëmbajtje dhe të			TATIMI I THJESHTUAR	
4	**Shpenzime për pagat**			**FITIMI MBAS TATIMIT**	
a	Pagat			PAGUAR TATIM	
b	Sigurime shoqërore dhe të ngjashme			SHUMA PËR T'U	
5	**Amortizimi i aktiveve**				
	TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4+5)		**B**	**HUMBJE**	

* në shitje dhe blerje do të shënohet vlera bruto e faturuar. **INSPEKTORI KONTROLLUES** **PERSONI VETËDEKLARUES** (Emri, mbiemri, firma) (Emri,

Shtojca nr. 5: LIBRI I AKTIVEVE

LIBRI I AKTIVEVE

PASOYRA E LLOGARITJES SË AMORTIZIMIT TË AKTIVEVE* PËR VITIN.....
Tatimpaguesi.....
Nipt.....
Aktivitet.....

Nr.	**EMËRTIMI I AKTIVI**	**VLERA FILLESTARE E AKTIVI**	**Ndryshimet gjatë**			**Koeficienti i amortizimit në%**	**AMORTIZIMI I AKUMULUAR**	**AMORTIZIMI I LLOGARITUR 31**	**GJITHSEJ AMORTIZIM 31**
			HYRJE AKTIVESH	**DALJE AKTIVESH**	**TOTALI 31 DHJETO**				
		a	*b*	*c*	*d=a+b-c*	*e*	*f*	*g = d x e*	*h = f + g*
GJITHSEJ									

** Aktive konsiderohen ambienti i aktivitetit, makineri dhe pajisjet dhe çdo mjet apo pasuri e paluajtshme që është regjistruar sipas ligjit të tatimit mbi të ardhurat*

Shtojca nr. 6 : FATURË E THJESHTË TATIMORE

Seria : 00

FATURË E THJESHTË TATIMORE

Nr._____Datë_____

Shitësi (emri i subjektit)

NIPT | | | | | | | | | | | **Nr 000000**

Adresa……. .....…..

Blerësi (emri i subjektit)

NIPT | | | | | | | | | | |

Adresa.....

Transportuar me mjetin……. Transportues i pavarur…….
Tipi……Targë…….. Tipi……Targë…….
Emri, mbiemri……
Pronë e shitësit/blerësit……. NIPT…….

Nr.ren.	Lloji i mallit apo shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefta
	TOTALI				

Formulari E-TBV 055/a

Emri dhe nënshkrimi i blerësit a) faqe 1: Origjinali – Blerësit
b) faqe 2: Shitësi Emri dhe nënshkrimi i shitësit
(.....) (.....)

Vula

Shënim. Kjo faturë lëshohet nga çdo subjekt përfshirë personat juridikë, fizikë tregtarë dhe çdo ent shtetëror ose privat, të cilët nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së.

Shtojca nr. 7 : DËFTESË TATIMORE

DËFTESË TATIMORE

Nr._____datë_____

Shitësi: _____
NIPT: _____
Adresa: _____

Nr.rendor	Lloji i mallit ose shërbimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefta
TOTALI					

Emri dhe firma e shitësit
(_____)

Shënim. Kjo dëftesë zëvendëson kuponin e kasës dhe lëshohet nga subjektet për shitjet me pakicë të mallrave ose shërbimeve, në rastet kur:
- subjekti, në bazë të dispozitave në fuqi, nuk është i detyruar të pajiset me kasë regjistruese fiskale.
- subjekti, për arsye objektive (mungesë energjie elektrike, prishje e kasës regjistruese fiskale), nuk mund të lëshojë kupon tatimor nëpërmjet kasës regjistruese fiskale.

AKT-RAKORDIMI
(Shtuar me udhëzimin nr. 13, datë 6.5.2014)

I mbajtur në datën_____, midis Drejtorisë Rajonale Tatimore _____ dhe komunës/ bashkisë_____, lidhur me totalin e shumës së arkëtuar, nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, në llogarinë përkatëse të DRT-së, për periudhën nga data_____deri në datën

Lloji i taksës	Emri i komunës/bashkisë	Llogaria kontabile (ku kanë kaluar arkëtimet)	Muaji në të cilin janë bërë arkëtimet	Shuma e arkëtuar gjithsej (në lekë)	Shuma e të ardhurave për komunën/bashkinë (99% e totalit)	Shuma e të ardhurave që i takon DRT-së (1% e totalit)
1	2	3	4	5	6=5 x 99%	7 = 5 x 1%
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e		4481100	01 deri 00/00/2014			

biznesit të vogël						

Shënim. Akt-rakordimi përpilohet në tri kopje. Akt-rakordimit i bashkëngjitet lista e tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët. Shuma totale e tatimit të arkëtuar (shuma në kolonën 5) duhet të jetë e barabartë me shumën totale të listës (sipas udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013) bashkëngjitur akt-rakordimit.

Për komunën/bashkinë_____
Nëpunësi zbatues (emër, mbiemër)
Nëpunësi autorizues (emër, mbiemër)

Për Drejtorinë Rajonale Tatimore_____
Nëpunësi zbatues (emër, mbiemër)
Nëpunësi autorizues (emër, mbiemër)